



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:173357

Datë: 08.11.2021

Numri i dokumentit: 02372771

0

P. nr.10/21

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti** me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit L. M. nga fshati . . . , Komuna Gjakovë , për shkak të veprës penale vjedhje pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së -së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/II.nr.1513/21 e datës 14.01.2021, në shqyrtimin publik gjyqësor të mbajtur më datë **03.11.2021** , në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj , përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit T. M. av. Ylli Bokshit, sipas autorizimit , të akuzuarit L. M. dhe mbrojtësit të tij av. Urim Pozhegu, sipas autorizimit, **me dt. 05.11.2021** mori dhe shpalli ndërsa përpiluar me datë 08.11.2021 këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **L. M.** nga fsh . . . K Gjakovë, data e lindjes . . . ,në Gjakovë , i biri i N. dhe i nënës M. e gjinisë Sh. ,ka të kryer shkollën fillore , i pa punë ,i gjendjes se dobët ekonomike, i martuar , atë i 3 fëmijëve, shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës, ID . . .

**Ë s h t ë f a j t o r:**

**Sepse :**

**-me datë 24.q10.2020 , në fshatin . . .ë, Komuna Gjakovë** , saktësisht në vendin e quajtur “ . . .” e cila evidentohet t si ngastër kadastrale me numër . . .-4 dhe . . . 3 pronë e të dëmtuarit T. M. , i pandehuri me qëllim të përvetësimit të pasurisë në mënyrë të kundërligjshme , me sharrë motorike ka prerë[ rreth 8 m<sup>3</sup> dru të llojit “Bung “ dhe më pas i ka dërguar në shtëpinë e tij, me ç ‘rast n të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 400 Euro.

**- me çka ka kryer veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

**Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 43, 46, 47, 48 49, si dhe nenit 349 par.2 lidhur me par.1 të akuzuarit i shqipton :**

**DENIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6(gjashtë ) muaj**, i cili dënimi nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale dhe dënim me gjobë ne shumë prej **200.oo (dyqind).-€**, të cilin shumë obligohet që ta paguaj

në afat prej 30 ditësh , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 43 par.3 të KPRK-së ,atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi , në kohëzgjatje prej **10(dhjetë) ditësh** , duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20(njëzet).-€**.

I dëmtuari T. P. M. nga fshati . . .ë, Komuna Gjakovë ,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30.00 €**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30.00 €**, në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë .

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritë aktakuzën PP/II.nr.1513/20 të datës 14.01.2021, ndaj të akuzuarit L. M. nga fshati . . .ë, Komuna Gjakovë, për shkak se ka kryer veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par.1 , dhe ka propozuar që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të gjykohet sipas Kodit Penal.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 17.05.2021 , përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Kastriot Memaj , deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës PP/II.nr1513/20 të datës 14.01.2021 por sa i përket palës së dëmtuar sipas ngastrave kadastrale duhet të jetë T. M. . Në fjalën përfundimtare të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 02.11.2021 prokurori i shtetit Anton Hasanaj deklaroi se :

Meqenëse i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë gjykata ka caktuar shqyrtimet gjyqësore me datën 17.05.2021, 03.08.2021, 29.09.2021 me ç'rast ka administruar të gjitha provat e propozuara nga ana e palëve si : deklarata e të dëmtuarit T. M., në cilësi të dëshmitarit , deklarata e dëshmitarit D. F. , deklarata e dëshmitarit M. T. si dhe ka administruar provat materiale si : raporti i policit P. K. me ID 6450 me nr. Të rastit 2020-Ea-1259 i datës 26.10.200 , , Certifikata mbi të drejtën e pronësisë e datës 04.11.2017, në emër të T. P. M. , Kopja e Planit e datës 24.08.2018 e lëshuar nga Drejtoria për Kadastër , Gjeodezi dhe Pronë në emër të T. P. M., e datës 24.10.2018 e lëshuar nga Procesverbali për vlerësimin e masës drunore me nr. 109/20 i datës 28.10.2020 nga Drejtoria për Bujqësi , pylltari dhe Zhvillim Rural në Gjakovë , fotografitë e drunjtëve të prerë si dhe të vendit ku janë prerë drunjtë , Raportit të njësive kadastrale të krijuara nga Agjencia për Kadastër dhe gjeodezi e datës 21.08.2020,Aktvendimit të datës 07.12.1974 i lëshuar nga Komisioni Komunal në Gjakovë ,procesverbali me nr. 03.8933/68 i datës 03.07.1983 , Kërkesa për regjistrimin e paluajtshmërisë drejtuar DDKGJP në Gjakovë si dhe Përgjigja nga Drejtoria për Kadastër , Gjeodezi dhe Pronë – drejtoresha A. L. e datës 12.08.2021.

I akuzuari L. M. në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 03.11.2021 ,pas administrimit të provave, deklaroi se në këtë fazë të procedurës e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës duke i ditur edhe më parë pasojat dhe favorët e pranimi të fajësisë dhe atë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Urim Pozhegu , shtoj se më vjen keq për veprën e kryer për të cilën nuk kam qenë në dijeni se paluajtshmëria është në emër të dëmtuarit , premtimi se një veprim i nuk do të përsëritet r në të ardhmen , kërkoj falje nga i dëmtuari për dëmin e shkaktuar , gjendjen e tij të dobët ekonomike dhe se më parë nuk ka qenë i dënuar.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i të akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e kanë bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza ,ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 të KPPK-së,dhe shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me fjalën përfundimtare

Në fjalën përfundimtare Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , deklaroi se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor i akuzuari L. M. është deklaruar fajtor për veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së , i cili pranim gjenë mbështetje të plotë edhe në provat materiale dhe personale që janë administruar edhe gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, pra me vet pranimin e fajësisë është vërtetuar në tërësi edhe gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës se i njëjti me datë vend , vend dhe mënyrë ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, andaj i propozoi gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor , ta dënojë konform ligjit duke vlerësuar më parë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe njëherit të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale .

Përf. i autorizuar i të dëmtuarit T. M. av. Ylli Bokshi në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shteti, sa i përket lartësisë së dënimit e lë në vlerësim të gjykatës dhe kërkojmë kompensim dëmi ..

: Mbrojtësi i të akuzuarit L. M. av. Urim Pozhegu , në fjalën përfundimtare deklaroi se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor sot para gjykatës i mbrojturi im L. M. ,ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale me të cilën inkriminohet në mënyrë të sinqertë dhe assesi si një beneficion të cilën e ofron ligji në mënyrë formale . Gjatë procedurës në si mbrojtje kemi marr disa informacione të cilat kanë të bëjnë me bartjen e pronësisë se paluajtshmerit që janë objekt i kësaj aktakuze , të cilat fakte i mbrojturi im nuk i ka pasur të ditura, dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës penale edhe kemi përpiluar parashtrësën e dt. 15.10.2021 .Ndryshimet sa i përket pronarit në gjendjen kadastrave respektivisht në emër të T. M. , i mbrojturi im pasi i ka kuptuar , i njëjti me rastin e prerjes së drunjëve në këto palujtshmeri , jemi të bindur se ka pasur përfytyrim të gabuar ,duke menduar se prerjen e drunjëve po e bënë në malin –palujtshmerin e lënë nga prindi i tij për faktin se dokumentacioni të cilën ai e posedon për të nijetin ka menduar se mali është prone e prindit të tij , që rrjedhimisht nënkupton se L. M. ka qenë nën lajthim, faktik lidhur me tiparet dhe elementet e veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 349/2-1 të KPRK-ës. e nëse i referohemi praktikës gjyqësore lidhur me këtë vepër penale , për të mbrojturin tim kjo përben bazë të mjaftueshme ligjor e cila përjashton dashjen në mënyrë kategorike, Andaj gjykata duhet që sipas detyrës zyrtare këtë rrethanë ta merr parasysh me vlerësimin e të gjitha provave shfajësuese. Gjykatës se nderuar i i kërkojë që me rastin e vendosjes të ketë parasysh të gjitha rrethanat tjera që kanë të bëjnë me rregullat e përgjithshme për marrjen dhe zbutjen e dënimit të paraparë me nenin 69 dhe 70 të KPRK-ës , siç është pranimi i fajësisë , ,gjendjen e dobët ekonomike, sjelljen korrekte gjatë procedurës , se asnjëherë nuk ka rëndesh me ligjin , mbajtësi vetëm i familjes 5 anëtarësh ,është person me nevoja të veçanta psiko fizike dhe premtimin i tij se në të ardhmen do të jetë me i kujdesshëm që të mos përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme , përderisa për të njëjtin nuk është gjetur apo konstatuar ndonjë rrethanë rënduese ,andaj i propozoi gjykatës që ti shqiptojë një dënim nën minimumin e paraparë ligjor.

I akuzuari L. M. ,në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i tij .

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojet e tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Rrethana rënduese gjykata e konsideron faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi , ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar

rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është i baba i 3 fëmijëve ,pranimin e fajësisë në shqyrtimin gjyqësor , gjendjen e dobët ekonomike , person me nevoja të veçanta , sjelljen e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte , me shqyrtim fillor dhe asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin , nuk ka qenë i dënuar . Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personalitetit i tij që te gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm , korrekt, i është penduar thellë për veprën penale, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , kërkim falja e nga e dëmtuari për dëmin e shkaktuar ,kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese gjykata të akuzuarit ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale ,shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit , personalitetin e të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj te akuzuarit do te arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 47 të KPRK-ës. dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij ,do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale , ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 463 par. 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarin T. M. Sh., për realizimin e kërkesës pasurore juridike ti udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, të kërkesës pasurore juridike edhe pse i dëmtuari gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se nuk parashatrojnë kërkesë pasurore-juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe atë në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30.00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së, dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € ,është marr konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimit .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.10/21 më datë 05.11.2021**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.